



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Ministarstvo Poljoprivrede,
Sumarstva i Ruralnog Razvoja- Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development*

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3. (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 14 paragrafi 14.5 dhe nenit 44 paragrafi 44.2 Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore të shpallur me Rregulloren e UNMK-ut nr 2006/37 mbi shpalljen e ligjit për tokën bujqësore të miratuar nga Kuvendi Kosovës me 23 Qershor 2010,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2011
Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.10/2010 për
Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, dt.19.08.2010

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ bëhet Ndryshim Plotësimi i Udhëzimit Administrativ NR.10/2010 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, dt.19.08.2010.

Neni 2

Neni 4 paragrafi 13.5 të Udhëzimit Administrativ NR.10/2010 teksti “Komisioni duhet të jetë pesë (5) anëtarësh dhe duhet të përbëhet nga dy (2) përfaqësues të APK-së, dy (2) përfaqësues të Departamentit të Pylltarisë dhe (1) përfaqësues i Departamentit të Zhvillimit Rural” zëvendësohet “Komisioni duhet të jetë pesë (5) anëtarësh dhe atë në përbërje: nga tre (3) përfaqësues nga APK-së, një (1) përfaqësues nga Departamenti i Pylltarisë dhe një (1) përfaqësues nga Departamenti i Zhvillimit Rural dhe Shërbimeve Këshillimore”, ndërsa teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Neni 3

Neni 4 paragrafi 13.6 i Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010 fshihet i tërë teksti dhe plotësohet me “Investitori – Shfrytëzuesi i pyllit dhe tokës pyjore shtetërore dhe private obligohet të siguroi garancionin bankar ose nga Kompanitë e Sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës për përmbushjen e detyrimeve në formën e përcaktuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës. Lartësia e garancionit, duhet të jetë së paku 30% e shumës së paraparë për realizimin në kohë dhe sipas nevojës së planit të rikultivimit.

Pas përfundimit të projektit, duhet të bëhet ri-kultivimi i tokës pyjore sipas Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ MA-NR.36/2006 për rikultivimin e tokës bujqësore të dt.27.12.2006 si dhe sipas kushteve të përcaktuara me kontratë.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, më 01.02.2011

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Blerand Stavileci
